



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**“ISA BOLETINI”**  
**FAKULTETI I EDUKIMIT**

Nr. Prot. 491 Dt 18.11.2021

Në bazë të vendimit të Këshillit të Fakultetit të Edukimit të datës 20.10.2021 me Nr. Prot. 37015 të datës 20.10.2021 është formuar Komisioni i ankesave për kandidatët të cilët kanë aplikuar në konkursin për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime, në bazë të nevojave të njëjësive akademike në Universitetin “Isa Boletini”, për vitin akademik 2021-22 të datës 01.10.2021 me Nr. Prot. 1712. Komisioni është mbledhur me datën 16.11.2021 për të shqyrtuar ankesën e Fatmir Misimi e paraqitur me Nr. Prot. 476 me datën 15.11.2021, komisioni i lartëcekur mori këtë:

**R A P O R T**

- I. **REFUZOHET si e pabazuar** Ankesa e parashtruar me Nr. Prot. 476 të datës 15.11.2021 nga kandidati Fatmir Misimi.
- II. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Me konkursin e datës 01.10.2021 me Nr. Prot. 1712 Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë ka shpallur Konkursin për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime për vitin akademik 2021-22.

Komisioni vlerësues me datë 09.11.2021 ka përpiluar raportin vlerësues për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime për vitin akademik 2021-22, për pozitën një mësimdhënës për lëndët: Edukim shëndetësor dhe Vështirësi në të nxënë.

Sa i përket pikës së ankesës që nuk duhet të jenë anëtar të komisioneve vlerësuese stafi që mbajnë pozita kyçe, kjo vlen vetëm për anëtar të komisionit të ankesave, po ashtu kandidati ju referohet rregullores për avancim e jo rregullores për angazhim.

Sa i përket pikës së ankesës se anëtarët e komisionit nuk janë nga fusha e ngushtë, komisioni konstaton se përbërja e komisionit është konform rregullores.

Sa i përket pikës që nuk është ftuar në intervistë, kjo vlen vetëm për konkursin për stafin e rregullt e jo për angazhim, sipas rregullores për angazhim.

Sa i përket pikës që nuk i është vlerësuar punimi shkencor, komisioni i ankesave konstaton se komisioni vlerësues e ka vlerësuar kriterin e pikës 2 të nenit 7 të Rregullores për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM,

Sa i përket notës mesatare të studimeve themelore, nuk merret në shqyrtim pasi që nuk kërkohet në rregullore, po ashtu sa i përket përvojës së punës, kandidatit në fjalë i mungon përvoja në Universitete Publike siç kërkon Rregullorja për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM.

Sa i përket pikës së ankesës për mos shpalljen e pozitës së lirë për lëndët: Edukim fizik me metodologji dhe Edukim fizik në edukim parashkollor, kjo pikë nuk shqyrtohet pasi që konkursi është publikuar i korrigjuar me datën 04.10.2021.

Komisioni konstaton se sa i përket përparësisë së kandidatit që është zgjedhur, ai plotëson fushën e ngushtë të studimit me lëndët për të cilat është shpallur konkursi në krahasim me kandidatin që ka bërë ankesë i cili nuk është në fushën e ngushtë. Po ashtu edhe sa i përket përvojës së punës në Universitet Publike, kandidati i përzgjedhur ka përvojë të gjatë dhe sipas rregullores ka përparësi ndaj kandidatëve tjerë, me Rregulloren për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM, të paraqitur në Nenin 7 Paragrafi 2.1.


Komisioni i ankesave i propozon Këshillit të Fakultetit, që të refuzohet si e pa bazuar kjo ankesë.

Komisioni:

Prof. Ass. Dr. Eliza Avdiu, Kryetare

Ass. Leonora Çarkaj, Anëtare

Ass. Ylli Hashani, Anëtar





UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË  
Fakulteti i Edukimit

Nr.prot 505/1 Dt. 19.11.2021

KËSHILLI I FAKULTETIT TË EDUKIMIT, në mbështetje të në mbështetje të nenit 72 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, dhe nenit 22 pika 1 të Rregullores mbi zgjedhjet në Universitetin e Mitrovicës dhe punën e Këshillit të Fakultetit më datë 19.11.2021 merr këtë:

V E N D I M

1. MIRATOHET raporti i komisionit të ankesave nr. 491 dt. 18.11.2021 për refuzimin e ankesës së paraqitur nga kandidati Fatmir Misimi, ndaj raportit të komisionit recenzues nr.444, dt 09.11.2021, i publikuar në Buletinin e Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, raporti i komisionit të ankesave së bashku vendimin e Këshillit të Fakultetit i dërgohen Senatit të UIBM për miratim.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni i ankesave ka përpiluar raportin vlerësues dt. 18.11.2021 nr.491 pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur ndaj raportit të komisionit recenzues nr. 444, dt.09.11.2021 për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime për vitin akademik 2021-22, Një mësimdhënës për lëndët: Edukim shëndetësor, Vështirësitë në të nxënë

Komisioni i ankesave ka konstatuar se sa i përket përparësisë së kandidatit që është zgjedhur, ai plotëson fushën e ngushtë të studimit me lëndët për të cilat është shpallur konkursi në krahasim me kandidatin që ka bërë ankesë i cili nuk është në fushën e ngushtë. Po ashtu edhe sa i përket përvojës së punës në Universitet Publike, kandidati i përzgjedhur ka përvojë të gjatë dhe sipas rregullores ka përparësi ndaj kandidatëve tjerë, me Rregulloren për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM, të paraqitur në nenin 7 paragrafi 2.1.

Komisioni i ankesave i propozon Këshillit të Fakultetit të Edukimit që të refuzohet si e pa bazuar kjo ankesë.

**I dorëzohet:**

Zyrës për çështje akademike  
Sekretarit të FEdu  
Arkivit të fakultetit

Kryesuesi i Këshillit të Fakultetit  
Prof. Ass. Dr. Besim Gollopeni

